
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018.

Objekti: **Rikualifikimi Urban, blloku kufizuar nga rruget "Muhamet Gjollesha", rruga "Myslym Shyri", "Rruga e Kavajës", me kufirin e Njesisë Administrative Nr 10.**

Investitori: Bashkia Tiranë
Vlera e Investimit: 124,571,091 lekë
Periodha kohore: Qershor 2016 deri në qershor 2017
Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt është zbatuar brenda zonës së Unazës së Mesme të qytetit të Tiranës, në një bllok banimi në anën jug - lindore të kryqëzimit të 21 Dhjetorit, pjesë e Njesisë Administrative Nr. 7, Bashkia Tirane. Blloku i banimit ku është investuar kufizohet me rrugën "Muhamet Gjollesha", rrugën "Myslym Shyri", rrugën "Rrugës së Kavajës" dhe me kufirin e Njesisë Bashkiake Nr. 10, me një sipërfaqe të përgjithshme të këtij blloku banimi rreth 80,000 m² (sipërfaqja e shënuar përfshin ndërtesat, rrugët, sheshet, trotualet, muret rrethuese, oborret e shtëpive e vilave, sipërfaqet e gjelbëruara, etj). Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së bllokut të banimit në momentin e investimit ka qenë pjesërisht e amortizuar. Është një zonë banimi e vjetër, me ndërtime të kryera kryesisht para viteve 1990 dhe me infrastrukturë të rregulluar shumë vite më parë.

Projekti ka ndërhyrë në rikualifikimin urban të përgjithshëm të këtij blloku banimi, duke përfshirë rikonstrukcionin e shtresave rrugore të rrugëve kryesore të zonës (shtrimin me binder dhe shtrimin me asfalt të tyre), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugëve të brendshme, me të gjithë komponentët e saj (stabilizanti plus nënshtresat e tjera), në rehabilitimin e rrjetit të ujërave të bardha dhe të zeza, me rikonstrukcionin e të gjitha pusëve të ujërave të bardha e të zeza, në sistemimin e plotë të trotuareve, bordurave anësore të rrugëve, në rehabilitimin e rrjetin e ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, në sistemimin dhe rehabilitimin e hapësirave të lulishteve plus disa sheshe te vegjël që shërbejnë për parkime të jashtëm të banorëve, etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rehabilitim pothuaj të përgjithshëm të këtij blloku banimi. Është një zonë banimi, kryesisht me pallate banimi 5 dhe 6 katëshe, si dhe ndërtime të reja pallatesh tetë e nëntë katëshe të ndërtuara vitet e fundit, me infrastrukturë të rregulluar shumë vite më parë (para viteve 1990), por që në momentin e investimit ka qenë e nevojshme ndërhyrja për rehabilitimin e saj, kjo edhe për shkak të amortizimit dhe kohës së gjatë pa investuar në këtë bllok banimi.

Punimet kanë filluar rreth muajit qershor të vitit 2016, e kanë përfunduar në muajin qershor të vitit 2017, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Vlen të përmendet se zbatimi i punimeve për këtë bllok banimi është bërë në kushte optimale, pasi rrugët e sheshet e brendshme gjatë periudhës së rikonstrukcionit, kanë qene pothuajse të bllokuara. Afati i garancisë së punimeve për objektin nuk ka përfunduar akoma (afati i garancisë së punimeve për këtë objekt, duhet detyrimisht të jetë deri në dy vjet). Afati konform datës së përfundimit të

punimeve plotësohet rreth muajit qershor 2019. Nisur sa më sipër investitori (Bashkia Tiranë) do duhet të kontrollojë menjëherë investimin, për të gjithë komponentët e tij, si dhe të hartojë preventivin rehabilitues për t'ja paraqitur firmës zbatuese brenda afatit të garancisë. Edhe pse objekti ka vetëm 18 muaj që është përfunduar, cilësia e zërave kryesorë të punimeve është në kushte poshtë nivelit mesatar. Vlen të theksohet se është bllok banimi vetëm me trafik të brendshëm për banorët e tij.

Nga pamja vizuale e objektit konstatohet se:

- ✓ Trupi i rrugës ka lëvizje të vogla (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit.
- ✓ Në disa segmente ka sipërfaqe të shtresave të asfaltit, të cilat kanë filluar që të thërrmohen (gjë që tregon se shtresa e asfaltit të hedhur, nuk është material cilësor dhe sipas standardeve).



Fig. 1
Shtresa asfaltike te demtuara vetem pak muaj pas kryerjes se investimit, nderhyrje e cila ka sjelle nje degradim te cilesise dhe qendryshmerise te rruges

- ✓ Vihen re ulje e lëvizje të pllakave të trotuarëve si dhe thyerje e tyre.
- ✓ Trotuarët anësorë të rrugës janë variabël (diku është 1.2 m diku 0.5 m, diku vetëm bordura anësore e rrugës, e diku nuk ekzistojnë fare).
- ✓ Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e trotuarëve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa pjesë të rrugëve ato pothuajse mungojnë plotësisht).

- ✓ Ka puseta të dëmtuara e të vendosura jo në nivel të njëtrajtshëm me trupin e rrugës (me parete anësore të tyre të dëmtuara).



Fig. 2

Parete anësore të pusetave jo të njëtrajtshme dhe të dëmtuara për shkak të materialit të dobët të

- ✓ Shtresat e betonit e kunetave anësore në disa segmente rrugore, kanë dëmtime dhe plasaritje të dukshme. Ka diferencë të dukshme të cilësisë e markës së betonit të hedhur në kunetat anësore brenda të njëjtës rrugë. Në një pjesë të kunetave nuk është hequr akoma materiali i lëndës së drurit të përdorur nga firma zbatuese, për lënien e fugave të betonit për kunetat anësore të rrugës. Në disa segmente rrugore kunetat

anësore prej betoni mungojnë plotësisht e janë zëvendësuar me shtresën e asfaltit.

Fig. 3

Shtresa asfaltike të dëmtuara



-
- ✓ Bashkia do të duhet të punojë me shumë për lirimin e hapësirave publike të zëna me ndërtime nga qytetarët, qoftë edhe duke hartuar të gjithë korrespondencën e nevojshme zyrtare, për lirimin e plotë të këtyre hapësirave të zëna nga banorët. Njoftimi zyrtar nga institucioni i bashkisë qoftë edhe për të mos investuar më në këto hapësira të zëna, të cilat së shpejti mund të shpronësohen apo të lirohen nga bashkia (pasur parasysht spostimin e mureve anësore, gardheve kufizuese, ndërtimeve pa kriter, etj).

Vihet re grumbullim i materialeve inerte (rërë+zhavor), në një pjesë të pusetave të ujërave të shiut. Pastrimi i tyre nga punonjësit e mirëmbajtjes së bashkisë nuk bëhet rregullisht duke sjellë përmytje e dalje të ujërave të bardha, gjatë rreshjeve të shiut (në rrugën e brendshme që kalon paralelisht me rrugën "Muhamet Gjollës", kishte shenja të dukshme të daljes së ujërave të shiut në rrugë, e evidentuar kjo situatë edhe nga banorët e zonës).

Në disa segmente rrugore menjëherë pas përfundimit të këtij investimi, është riinvestuar po nga Bashkia Tiranë, për sistemimin e ujit të pijshëm. Kjo tregon një mosprogramim të qartë të investimeve të kryera nga i njëjti institucion. Ndërhyrja e bërë nuk është bërë konform standardeve të kërkuara, ku dallohet qartësisht ulja e shtresave të asfaltit në kanalim e hapur, krahasuar me shtresat asfaltike të shtruara gjatë rehabilitimit.

Defektet e shfaqura në shtresat asfaltike të rrugës, trotualet anësore të saj, thyerja e kapakëve të pusetave, heqja e lëndës së drurit dhe plotësimi me fuga i të gjithë shtresave prej betoni të kunetave, do duhet detyrimisht ti bëhen prezente firmës zbatuese të punimeve nga specialistët përgjegjës pranë Bashkisë Tiranë. Firma zbatuese e punimeve do duhet në mënyrë të menjëhershme të ndërhyjë me fondet e veta, për riparimin e menjëhershëm të defekteve të evidentuara, pa pritur degradimin e mëtejshëm të saj, apo përfundimin e garancisë së punimeve të objektit (fondi garancisë së objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar). Vetëm pas riparimit të defekteve të shfaqura Bashkia Tiranë duhet të bëjë zhbllokimin e garancisë së punimeve për këtë vepër.

Konkluzione në lidhje me objektin:

- *Do të duhet të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit të trupit të rrugëve dhe aty ku dukshëm asfalti rezulton i gripuar (dëmtuar) të rishtrohet e gjithë shtresa e asfaltit.*
- *Të bëhet riparimi i uljeve të pllakave të parapërgatitura të trotuarëve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to.*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar në trotualet për lidhje të njëtrajtshme të tyre me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza (zëvendësimi i kapakëve të dëmtuar dhe betonit të dëmtuar përreth tyre).*
- *Bashkia Tiranë do duhet detyrimisht të rakordojë punën midis gjithë institucioneve përkatëse shtetërore siç janë: Ndërrmarja e Ujësjetës & KESH në mënyrë që kur të programohet investimi në rrugë apo në bllokun e banimit, në mënyrë që të shmangët rindërtimi pasi është bërë njëherë.*
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e defekteve të konstatuara zë rreth 5 deri 10 % të vlerës së situacionit përfundimtar, për të cilat do duhet të informohet menjëherë firma zbatuese e punimeve.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 15.01.2001, Nr. 2, datë 13.05.2005 dhe Nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

Bashkëlidhur një foto ajërore e bllokut të banimit ku është investuar.
(me vijë të kuqe është kufizuar blloku i banimit ku është kryer rehabilitimi)

